

VENDIM
Nr. 47, datë 11.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i “	“	
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 19.9.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 25 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Afërdita Papamihali

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2013-387 (33) të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2013-387 (33) të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; vendimi nr. 47, datë 26.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 300, datë 10.11.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka vendosur:

“Deklarimin fajtores të së pandehurës Afërdita Papamihali, për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e saj me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe 500 000 lekë gjobë... Në bazë të nenit 35/2 të KP-së, heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurën Afërdita Papamihali, për një periudhë prej 3 vitesh”.

2. Me vendimin nr. 123, datë 13.9.2010, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 300, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në lidhje me të pandehurit Sotiraj Janora, Alfred Mamani, Leonard Mustafaraj dhe Petrit Maksuti. Prishjen e këtij vendimi në lidhje me të pandehurit Gaqe Meçi, Afërdita Papamihali dhe Admir Shehaj, dhe pushimin e çështjes ndaj tyre, pasi nuk vërtetohen elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar, atë të parashikuar nga neni 248 i KP-së.”* Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

3. Me vendimin nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 123, datë 13.9.2010 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për të gjykuar Gaqe Meçi, Afërdita Papamihali dhe Admir Shehaj, duke lënë në fuqi për këta të gjykuar vendimin nr. 300, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë...”*

II

4. **Kërkuesja Afërdita Papamihali** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për këto shkaqe:

4.1 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se ndaj kërkueses janë aplikuar dy dënime kryesore dhe, në kuptim të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese, ka pranuar paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e vendimit të gjykatës së faktit dhe ka ndryshuar vetë statusin e dënimit me gjobë, nga dënim kryesor në dënim plotësues. Në këtë drejtim, ky Kolegj, në kundërshtim me pjesën arsyetuese të vendimit të tij, në pjesën urdhëruese ka lënë në fuqi një vendim antikushtetues, duke e legjitimuar atë.

4.2 Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, sepse me këtë ndryshim ajo, efektivisht, ka realizuar politikën e dënimit, duke preferuar dënimin me burgim si dënim kryesor, përkundëjt atij me gjobë. Përcaktimi i dënimit kryesor për kërkuesen mund të jetë vetëm rezultat i çmimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të të gjykuarit, çka është atribut i gjykatës së faktit dhe nuk hyn në kontrollin ligjor të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë duhej të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatën e faktit për të konkluduar lidhur me dënimin kryesor për kërkuesen.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në parashtrimet drejtuar Gjykatës Kushtetuese, paraqet këto prapësime:

5.1 Në lidhje me pretendimin e parë, pjesa urdhëruese e vendimit të dënimit nuk përmend se të cilës natyrë janë dënimet e dhëna për kërkuesen, kurse pjesa argumentuese e tij është ndryshuar nga Gjykata e Lartë, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por ai nuk ka sjellë pasoja në pjesën urdhëruese. Në këtë mënyrë, për kërkuesen nuk është e rëndësishme se si do të quhet dënimi me gjobë (kryesor detyrues apo plotësues) në kuptim të nenit 34/5 të KP-së, por a do të duhet ta vuajë atë, pra a duhet të paguajë gjobën.

5.2 Në lidhje me pretendimin e dytë, ndryshimet që iu bënë KP-së në vitin 2013, mes të cilave është dhe neni 248 për të cilin është deklaruar fajtores kërkuesja, kanë ecur në linjë me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë aspekt, fakti që Gjykata e Lartë ka zgjedhur dënimin me burg si dënim kryesor është një rrjedhim logjik, i natyrshëm dhe ligjor dhe brenda kuadrit të saj të shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

III

Lidhur me kërkesën për pezullim

6. Mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese mori në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me vendimin e datës 20.6.2013, mbledhja e gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk ndodhej para kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) thekson se ajo i vlerëson pretendimet e kërkueses në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

A. *Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*

8. Kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, duke caktuar për të si dënim kryesor atë me burgim, përkundëjt atij me gjobë, ndërkohë që caktimi i dënimit kryesor mund të jetë vetëm rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të të gjykuarit, çka është

atribut i gjykatës së faktit. Në këtë kuptim, kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë duhej të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatën e faktit për të konkluduar lidhur me dënimin kryesor.

9. Gjykimi nga një “gjykatë e caktuar me ligj”, është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se termi “gjykatë” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë, përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 16, datë 27.3.2012; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket shprehjes “e caktuar me ligj”, kjo përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Gjykata ka vlerësuar se, nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është, ndër të tjera, parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar. Shqyrtimi i një çështjeje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e të drejtës kushtetuese për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykate tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë sanksionon dy lloje dënimesh, dënimet kryesore dhe ato plotësuese. Dënimet kryesore janë të parashikuara në nenin 29 të KP-së dhe, sipas kësaj dispozite, në llojin e dënimeve kryesore, të cilat mund të jepen nga gjykatat e zakonshme për personat që kanë kryer krime, hyjnë dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi me burgim dhe ai me gjobë. Ndërsa, për personat që kanë kryer kundërvajtje, dënimet kryesore janë dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Dënimi me burgim parashikohet nga neni 32 i KP-së, ndërsa dënimi me gjobë nga neni 34 i KP-së. Mes të tjerash, në paragrafin e pestë të tij, neni 34 parashikon dënimin me gjobë, krahas atij me burgim, “*për personat që kryejnë krime për motive fitimi të pasurive ose të sigurimit të çdo lloji përfitimi tjetër material.*” Përveç dënimeve kryesore, gjykatat, kur e çmojnë të arsyeshme, mund të caktojnë edhe një ose më shumë dënime plotësuese, të parashikuara nga neni 30 i KP-së, në lidhje dhe me nenet 35-43 të tij.

12. Me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, Gjykata vendosi shfuqizimin, si të papajftueshëm me Kushtetutën, edhe të nenit 29, paragrafi i fundit, të KP-së, duke arsyetuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit konkret të veprave penale, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore, në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e pjesës së posaçme të KP-së. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë të gjitha mundësitë, me parashikimet aktuale të KP-së, të japin dënimin me burgim si dënim kryesor, në të gjitha rastet e përcaktimit të dy dënimeve kryesore në dispozitat e pjesës së posaçme të KP-së, si dhe ta ashpërsojnë atë me dënimin me gjobë kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së.

13. Gjykata ka vlerësuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënit për autorët e veprave penale. Sipas nenit 47 të KP-së, në caktimin e dënit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Po ashtu, gjykatat e zakonshme, në bazë të sanksionimit, në Pjesën e Përgjithshme të Kodit Penal, të dënimeve plotësuese, si dhe në bazë të parashikimit të nenit 34, paragrafi i pestë, të KP-së, kanë

mundësinë e ashpërsimit të dënimit kryesor me një ose disa dënime plotësuese ndaj atyre autorëve të veprave penale rrezikshmëria e të cilëve është e lartë, ose të përcaktojnë edhe një masë ndëshkimi me gjobë ndaj autorëve të atyre veprave penale që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, duke realizuar, në këtë mënyrë, qëllimin e ligjvënësit në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet ashpërsimit të masave ndëshkuese (*shih vendimin nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, rezulton se ajo është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, pas shpalljes së vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në këtë vendim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se dënimi me gjobë në vlerën prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë për kërkuesen, i përgjigjet dënimit plotësues, pasi dënimi me gjobë nuk mund të jepet si dënim kryesor së bashku me dënimin me burgim. Si përfundim, Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi për kërkuesen si dënimin me burgim (si dënim kryesor), ashtu edhe atë me gjobë (si dënim plotësues).

15. Në lidhje me aplikimin e dënimit me gjobë krahas atij me burgim, kërkohet plotësimi i kritereve të parashikuara në nenin 34/5 të KP-së, pra kryerja e veprës penale për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material. Në rastin konkret, rezulton se kërkuesja Afërdita Papamihali është dënuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, dhe, në bazë të nenit 35/2 të KP-së, ndaj saj është dhënë si dënim plotësues “heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike”. Nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, që e ka dënuar kërkuesen, nuk rezulton që elementet që kërkon zbatimi i nenit 34/5 të KP-së të jenë analizuar dhe provuar në atë gjykim, duke qenë se dënimi me gjobë është aplikuar nga gjykata si pasojë e zbatimit të dispozitës ligjore në fuqi në momentin e gjykimit të kësaj çështjeje.

16. Vlerësimi i tërësisë së faktit penal, në lidhje me të gjitha elementet dhe rrethanat që e përbëjnë atë, me qëllim të individualizimit të shkallës së përgjegjësisë të të pandehurit dhe përshtatshmërisë së dënimit, hyn në fushën e diskrecionalitetit të gjyqtarit të faktit, kurse Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural dhe kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në këtë kuptim, në rastin konkret, Gjykata e Lartë, duke dhënë për kërkuesen dënimin me gjobë krahas atij me burgim, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë nuk ka hetuar nëse plotësoheshin kushtet e nenit 34/5 të KP-së, ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-387 (33), datë 31.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë Gjykatë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më 19.9.2013

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj